Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0783

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga:Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) N.T.SH. "Kastrati - L" (Luigj Kastrati B.I.) lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirembajtja e rrjetit te kanalizimeve brenda territorit te Komunes se Skenderajt "me nr. të prokurimit:"643-23-5477-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna Skenderaj, me datën 22.12.2023, mori këtë:

Vendim

I. Aprovohet, si pjeserisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.SH. "Kastrati - L" (Luigj Kastrati B.I.) , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 12.10.2023 (me numër protokolli 783/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirembajtja e rrjetit te kanalizimeve brenda territorit te Komunes se Skenderajt " me nr. të prokurimit: "643-23-5477-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Skenderajt.
II.Të mbetet në fuqi, vendimi për dhënie të kontratës nga AK.

III.Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 30.05.2023, Komuna e Skenderajt, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e rrjetit te kanalizimeve brenda territorit te Komunes se Skenderajt” me nr. të prokurimit: "643-23-5477-5-2-1”. Nderkaq me datën 29.09.2022 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE N.T.SH. “Kastrati - L” (Luigj Kastrati B.I.) me datën 03.10.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK- Komuna e Skenderajt merr vendim qe te refuzohet si e pa bazuar kërkesa per ri-shqyrtim e OE N.T.SH. “Kastrati - L” (Luigj Kastrati B.I.) . lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirembajtja e rrjetit te kanalizimeve brenda territorit te Komunes se Skenderajt” me numër te prokurimit: "643-23-5477-5-2-1" inicuar nga Autoriteti Kontraktues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues N.T.SH. “Kastrati - L” (Luigj Kastrati B.I.). me datën 12.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 783/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës:punë, vlera e parashikuar e kontratës:180,000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 07.11.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE N.T.SH. “Kastrati - L” (Luigj Kastrati B.I.).

I. Aprovohet, si pjeserisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.SH. “Kastrati - L” (Luigj Kastrati B.I.) , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 12.10.2023 (me numër protokolli 783/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirembajtja e rrjetit te kanalizimeve brenda territorit te Komunes se Skenderajt “ me nr. të prokurimit: "643-23-5477-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Skenderajt.

II.Të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Përgjigje në pretendimi nr.1.

Sqarim:

Ne ankesën e dt. 15.07.2023 nr 2023-0493 te bërë nga OE ankues per rastin e njejtë ky pretendim ankimor ka qenë i renditur nr 2.

Pretendimi ankimor nr.1 se operatori ekonomik ankues nuk ka plotësuar kërkesen e dosjes se tenderit dhe NJK ne plotësim te kërkesës III.2.4 Kapaciteti Teknik dhe profesional , pika b, ku është kërkuar inxhinier i diplomuar apo master drejtimi infrastrukturor rrugor, me se paku 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit.

> Sipas AK-Komuna e Skenderajt , inxhinier i prezentuar ne ofertën e OE ankues Z. Faton Kastrati, nuk e plotëson përvojën e punës sipas kërkesës se dosjes se tenderit sepse ne CV-në e tij shkruan përvoja e punës 01. Shkurt 2021-prezent.
>
> Eksperti shqyrtues bazuar ne CV-në e inxhinierit konstaton se ne CV ka te paraqitura edhe punë tjera qe ky inxhinier ka kryer edhe para dt. 01 Shkurt 2021 dhe po ashtu nëse marrim per bazë dt. e diplomimit te tij me 13.06.2018 dhe dt. e hapjes se ofertave 19.06.2023 plotësohet kërkesa e dosjes se tenderit. Është në përgjegjësin e AK-Komuna Skenderaj nëse do te i verfifikoj apo sqaroj CV-në përkatëse sipas nenit 72 te LPP-së, nenit 10.1 te Udhezuesit 001/2023.

Bazuar ne shkresat e lëndes dhe kërkesat e dosjes se tenderit, CV-ne ofruar nga OE ankues per inxhinierin ne perkates konstatojmë se ky pretendim ankimor është **i Bazuar.**

Përgjigje në pretendimi nr.2

Ky pretendim ankimor nuk ka qenë i paraqitur ne ankesën te dt. 15.07.2023 nr 2023-0493.

Sa i perkt pretendimit ankimor nr 2 se OE ankues nuk ka përmbushur piken III. 2.4 te Kapacitetit teknik dhe profesional pika c), sipas AK-KK Skenderaj operatori ekonomik ankues nuk ka plotësuar ketë kërkesë sepse Inxinieri i Gjeodezisë i prezentuar ne ofertën e OE ankues, i mungon Licenca e Gjeodezisë.

Eksperti shqyrtues ne lidhje me ketë pikë konstaton se ne CV e gjedotetit Fidan Hasaj shkruan se është i licensuar nga viti 2011.

Bazuar ne shkresat e lëndes dhe kërkesat e dosjes se tenderit, konstatojmë se ky pretendim ankimor është **pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në pretendimi nr.3

Ky pretendim ankimor nuk ka qenë i paraqitur ne ankesën te dt. 15.07.2023 nr 2023-0493.

Sa i perkt pretendimi ankimor nr 3 se OE ankues nuk ka përmbushur piken III. 2.4 te Kapacitetit teknik dhe profesional pika d), sipas AK-KK Skenderaj operatori ekonomik ankues nuk ka plotësuar ketë kërkesë sepse inxhinieri i diplomuar apo master i mjedisit nuk ka z. Vehbi Spahiu , nuk ka te nënshkruar CV.

Ne lidhje me ketë pikë rekomandojm qe AK-Komuna Skenderaj te trajtoj ketë pikë sipas nenit 72 te LPP-së, nenit 10.1 te Udhezuesit 001/2023, dhe te konstatohet nëse inxhinier përkatës qëndron prapa CV-se se tij.

Bazuar ne shkresat e lëndes, kërkesat e dosjes se tenderit, ofertën e operatorit ekonomik konstatojmë se ky pretendim ankimor është **pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në pretendimi nr.4

Ky pretendim ankimor nuk ka qenë i paraqitur ne ankesën te dt. 15.07.2023 nr 2023-0493.

Sipas AK-KK Skenderaj operatori ekonomik ankues nuk ka përmbushur kërkesen e dosjes se tenderit saktësisht ankesin 7 te DT. Sipas AK-KK Skenderaj OE ankues nuk ka prezentuar ne ofertën e tij Kamion Kiper me dy dyer nr targa: 01-735-SF, librezën me validitet te rexhistrimit te skaduar.

Dëshmia e kerkuar nga autoriteti kontraktues ne dosje te tenderit ne lidhje me ketë kërkesë nuk është e çartë sepse edhe vet autoriteti ka bërë nje formulim te tillë tek dëshmia e kërkuar "**Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje të marrjes me qira) të mjeteve, librezat e qarkullimit, ndërsa per ato mjete që nuk kanë libreza të qarkullimit. d Deklaratat unike doganore apo fatura. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët.**

Nga kjo shihet se AK kërkon librezat e qarkullimit ndërsa përkundër faktit qe e ka shkruar nuk e ka te sqaruar se si do te veprohet per ato mjete qe nuk kanë libreza te qarkullimit.

Bazuar ne kontraten ne mes te OE ankues dhe kompanis ISEFERI rezulton se kontrata është per 3 kamion kiper 10-17 tonë, referoju nenit 2 te kontartes saktësisht pikës 2.2.

Bazuar ne shkresat e lëndes , kërkesat e dosjes se tenderit, oferten ofruar nga OE ankues dhe kontratën ne mes te OE ankues dhe OE I SEFERI , konstatojmë se ky pretendim ankimor është **i Bazuar.**

Përgjigje në pretendimi nr.5

Sa i përket pretenimit ankimor nr 5, sipas te cilit AK-KK Skenderaj thekson se operatori ekonomik nuk ka përmbushur kërkesen sepse ka mospërputhje te dukshme ne nënshkrimin e CV-së se inxhinierit ne drejtimin Hidroteknikë z. Ilazi Muhaxheri.

Eksperti shqyrtues rekomandon qe AK-KK Skenderaj te bejë sqarimin e kësaj kërkese nëse ka dyshime te caktuara. Ne lidhje me ketë pikë rekomandojm qe AK-Komuna Skenderaj te trajtoj ketë pikë sipas nenit 72 te LPP-së, nenit 10.1 te Udhezuesit 001/2023, dhe te konstatohet nëse inxhinieri përkatës qëndron prapa CV-së së tij dhe nënshkrimeve te tij dhe te konstatohet nëse dokumenti ne fjalë i paraqitur ne ketë tender është me dijenin te personit përkatës (inxhinierit te Hidorteknike).

Bazuar ne shkresat e lëndes, kërkesat e dosjes se tenderit, ofertën e operatorit ekonomk konstatojmë se ky pretendim ankimor është **pjesërisht i bazuar.**

Përgjigje në pretendimi nr.6

Ne ankesën e dt. 15.07.2023 nr 2023-0493 te bërë nga OE ankues per rastin e njejtë ky pretendim ankimor ka qenë i renditur nr 1.

Ky pretendim ankimor i paraqitur ne ankesën e operatorit ekonomik ankues ne lidhje me mbetjen ne fuqi te vendimit te AK B58 mbi dhënien e kontratës se OE Deshishku shpk, Prishtinë, i cili ka te bejë me shkelje te nenit 61 te LPP-së Tenderet Jo-normalisht te ulë, paragrafi 1,2 nen paragrafi 2.1,2.2,2.3 dhe 2.4 dhe dispozitat e nenit 41 te Rregullores per Prokurim Publik 001/2022 , ky pretendim ankimor është trajtuar edhe ne raportin e ekspertit shqyrtues te dt. 08.08.2023 sipas te cilit "**Bazuar ne argumentet dhe faktet qe ka prezantuar OE ankues ky pretendim ankimor ne parim është i bazuar pasi qe sipas nenit 41. 6 dhe 8 te Rregullores për prokurim publik 01/2022 AK ka pas për obligim qe ta trajtoj ofertën e OE të rekomanduar por edhe operatorëve tjerë qe konsiderohen te suksesshëm që kane ofruar oferta me çmime abnormalisht te ulëta".**

Eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor është trajtuar ne raportin e ekspertit me dt. 08.08.2023 dhe ne Vendimin e Panellit te OSHP-se te dt. 07.09.2023 dhe si rrjedhoj nuk ka nevoj te trajtohet përsëri pasi qe kemi te bëjmë me pretendimin e njejtë ankimor.

Panelli shqyrtues përmes vendimit te dt.07.09.2023 nr 2023-0493 ka kërkuar qe AK-Komuna e Skenderaj gjatë rivlerësimit te ofertave te bëjë një hulumtim te tregu duke u bazuar ne fakte dhe prova te argumentuara dhe konform nenit 59 te bëjë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e te gjitha ofertave te përgjegjshme për ketë aktivitet te prokurimit.

AK-Komuna Skenderaj gjatë fazës se rivlerësimit sipas sqarimeve shtesë qe kemi kërkuar rezulton qe ka bërë hulumtim tregu dhe me datë 26.09.2023 ka përgatitur raportin mbi hulumtimin e tregut.

Nga hulumtim i tregut shihet se janë marrë nga AK-Komuna Skenderaj ofertat nga 3 operator ekonomik dhe rezulton se OE Ankues ka ne disa pozicione çmime te larta mbi mesataren e tregut te hulumtuara nga KK Skenderaj dhe te paraqitura përmes raportit te dt. 26.09.2023. Hulumti i tregut mbetet në përgjegjësin e AK-Komuna e Skenderaj nëse janë përdorur metodat me te mira te hulumtimit te tregut ne harmoni me qellimin e aktivitetit te prokurimit.

Bazuar ne aneks dokumentin i cili do te i bashkangjitet këtij raporti konstatojmë se disa çmime janë shumë me te larta se mestarja e hulumtimit te tregut dhe disa janë shumë me te ulëta se mesatarja e çmimeve te tregut. Po ashtu kemi nje ndryshim te madh te disa çmimeve ne mes te hulumtimit te tregut të bërë nga OE ankues dhe KK Skenderaj.

Operarotori ekonomik ankues ka çmime te larta ne krahasim me te gjithë ofertuesit tjerë, konstatim i cili është trajtuar nga eksperti shqyrtues edhe ne raportin e dt.08.08.2023, dhe cila shihet edhe përmes çmimeve te paraqitura ne procesverbalin e hapjes.

Po ashtu konstatojm se OE Ankues ka çmime te larta mbi mesataren ne disa pozicione te hulumtimit te tregut te bërë nga KK Skenderaj ndërsa edhe OE i rekomanduar per kontratë ka ne

këto pozicione çmime jo normalisht te ulëta në krashim me mesataren e çmimeve te hulumtimit te bërë nga AK Komuna Skenderaj.

Çmimet e tilla janë te bazuara ne hulumtimin e çmimeve te tregut të bëra nga AK Komuna e Skenderaj.

Me gjerësisht referoju aneks raportit te bashkangjitur.

Nga raporti i hulumtimit i bërë nga AK Komuna Skenderaj, çmimet per njësi te OE te rekomandur per kontratë dhe çmimet per njësi te OE ankues rezulton se kemi nje dallim te madh te çmimeve ne disa pozicione dhe si rrjedhoj e kësaj ne parim këta tender duhet te trajtohen sipas nenit 41.1 i cili thotë:

Neni 41 i Rregullores per Prokurim Publik

Tenderët Jo-normalisht të Ulët

41.1 Koncepti i tenderit jo-normalisht të ulët i referohet tenderëve që për autoritetin kontraktues në shikim të pare duken si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat, dhe që ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës.

Dhënia e nje kontratë me çmime me tilla te njësive me ndryshime te mëdha ne disa pozicione ka gjasa për një ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës.

AK-Komuna Skenderaj përmes përdorimit te kriterit te dhënies "Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët i peshuar (poentuar)"** nuk ka arritur te siguroj ofertën me te favorshme me çmime te tregut.

Bazuar ne përshkrimin e bërë me sipër sipas shkresave te lëndes, hulumtimit te tregut te berë nga AK Komuna e Skenderaj te dt. 26.09.2023, raportit te vlerësimit, dosjes se tenderit, pretendimeve ankimore te ankuesit, eksperti shqyrtues rekomandon panellin shqyrtues qe te anulohet Vendimi i AK-së i datës 29.09.2023 mbi dhënie e kontrates dhe te anulohet në tërësi njoftimi per kontratë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues:

- - Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues **OE "Luigj Kastrati B.I.** " është **pjesërisht e BAZUAR**

- Të anulohet **NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK-së** i datës 29.09.2023 mbi njoftimin per dhënie te kontrates

- Te Anulohet njoftimi per kontratë

Konstatimet e panelit shqyrtues

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Po ashtu vlenë të theksohet se për këtë aktivitet të prokurimit ka ekzistuar edhe një vendim i OSHP me Nr. 2023/0493, i datës 07.09.2023

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës sa i përket eleminimit të ankuesit janë të mjaftueshëm të argumentuara dhe me prova materiale, duke u kualifikuar ankesën si pjesërisht të bazuara andaj paneli e mbështet arsyetimin e ekspertit (për pretendime ndaj të eleminuarit) që ankesa të kualifikohet si pjesërisht e bazuar, sepse AK ka mundur të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP.

Por, sa i përket pohimit ankimor ndaj të rekomanduarit se ka çmimeve jo-normalisht të ulëta, me të drejtë eksperti shqyrtues këtë çështje e ka veçuar dhe cituar se kjo është trajtuar me vendimin paraprak të lartëcekur të panelit shqyrtues duke e obliguar AK që të bëjë një hulumtim të tregut sa i përke çmimeve të paraqitura në ofertë. Sipas ekspertit shqyrtues AK ka bërë hulumtim të tregut të cilin e ka paraqitur në raport dhe si rezultat i këtij raporti edhe ka ardhur në këtë përfundim dhe ka rekomanduar fituesin, panelin shqyrtues konstaton që vendimi paraprak është respektuar, lënda është kthyer në ri-vlerësim, janë bërë hulumtimet e tregut (për të cilën metodë është në diskrecion të AK) dhe për këtë paneli shqyrtues nuk ka si mos ta trajtoj ndryshme përveç çështje e gjykuar, konform nenit 105, paragrafi 2.16 të LPP, citat: "Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional. Duke e pasur parasysh që ankuesi ka çmimin më të lartë për 4 herë më shumë se sa ofertuesit të jerë, atëherë paneli nuk e pa të arsyeshme që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe të kërkohen sqarime për ankuesin. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe mbetet në përgjegjësi të AK në rastin konkret se a ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë

ligj”.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar haromoni me dispozitat e nenit 59, 60 dhe 61 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **K.K. SKENDERAJ**
- OE - **Luigj Kastrati B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: